



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 146/2 prot.

Tiranë më, 13/03 /2020

VENDIM

Nr. 7, datë 13.03.2020

“Për mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për administrator të Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë”

Në kuadër të nenit 47, nenit 48, nenit 49, pika 1, shkronja “g”, nenit 51, pika 2 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për administrator të Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë sipas formulës:
70 pikë Vlerësimi i dokumentacionit
30 pikë Intervista me gojë
100 pikë Total
2. Zhvillimi i intervistave për kandidatët do të bëhet pas dorëzimit nga Senati Akademik të listës së kandidaturave që plotësojnë kriteret.
3. Secili kandidat ka në dispozicion 15 minuta kohë për të paraqitur platformën për mënyrën sesi do të menaxhojë dhe administrojë Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë.
4. Vlerësimi për secilin kandidat do të jetë individual dhe do të bëhet në mënyrë të fshehtë nga secili anëtar i Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

